



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.164, datë 23.12.2021

PËR

NDRYSHIMIN DHE DETAJIMIN E PIKËS DY TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.575, DATË 20.12.2018 “PËR NDRYSHIMIN DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.60, DATË 22.12.2005 “PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË VENDODHJEVE TË REJA TË VENDQËNDRIMEVE TAKSI (4+1) DHE (8+1) NË QYTETIN E DURRËSIT” DHE MIRATIMIN E KRITEREVE SHITESË PËR OPERATORËT TAKSI, QË KRYEJNË SHËRBIMIN TAKSI NË TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, VKM-së nr. 663 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorrët me ndezje pozitive nga ana me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.12 datë 19.07.2007 për “Përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e liçensave, blloku të udhëtimit dhe regjistrin të shërbimit taksi” i ndryshuar, VKB nr.575, datë 20.12.2018 “Për ndryshimin dhe disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.60, datë 22.12.2005 “Për miratimin e krijimit të vendodhjeve të reja të vendqendrimeve taksi (4+1) dhe (8+1) në qytetin e Durrësit, dhe miratimin e kriterëve shtesë për operatorët taksi, që kryejnë shërbimin taksi në transportin rrugor të udhëtarëve”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin ndryshimin të VKB-së nr.575, datë 20.12.2018 duke detajuar pikën 2 të këtij vendimi si më poshtë vijon:
2. Miratimi i kritereve shtesë për liçensimin e operatorëve taksi, që kryejnë shërbimin taksi në transportin rrugor të udhëtarëve, si më poshtë:
 - a) Viti i prodhimit të të gjithë llojeve të automjeteve të shërbimit taksi për ato subjekte/individë të cilat do të aplikojnë për tu liçensuar në këtë shërbim për herë të parë do të jetë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 663, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorrët me ndezje pozitive nga ana me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete” i ndryshuar.
 - b) Ngjyra e mjeteve për këtë shërbim të jetë e verdhë për makinat, që kërkojnë të liçensohen për herë të parë taksi.
 - c) Përfundim nga parashikimi i përcaktuar në gërmën b të pikës 2, bëjnë automjetet elektrike të shërbimit taksi 4+1, të cilat duhet të jenë me ngjyrë të bardhë me logo jeshile.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2021



BASHKILIA DURRES
07/01/22 83

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. ~~998~~ / prot.
7

Durrës, më 05 . 01.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.164 datë 23.12.2021 “Për ndryshimin dhe detajimin e pikës dy të VKB Nr 575 dt 20.12.2018 “ Për ndryshimin dhe disa shtesa në VKB Nr 60 dt 22.12.2005 “Për miratimin e krijimit të vendndodhjeve të reja të vendqëndrimit taksi (4+1) dhe (8+1) në qytetin e Durrësit “ dhe miratimin e kriterëve shtesë për operatorët taksi që kryejnë shërbimin taksi në transportin rrugor të udhëtarëve.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

